

TERMAT E REFERENCËS

Pozicioni: Ekspert/e për studim

Numri i kërkuar: 1(Një)

Tipi i Kontratë: Kontratë Shërbimi

Kontraktuesi: Organizata Përtej Barrierave

Kohëzgjatja: 25 Korrik- 25 Gusht 2019

Afati i fundit i aplikimit: 18 Korrik 2019

RRETH ORGANIZATËS

Përtej Barrierave është një organizatë jo-qeveritare, jo-fitimprurëse e cila është themeluar në Qershor të vitit 2004 nga një grup te rinjsh me aftësi të kufizuar dhe të rinj të tjerë që sot janë pjesë e bordit drejtues të organizatës.

Misioni i organizatës është: të promovojë mundësi të barabarta për të gjithë të rinjtë dhe vecanerisht për të rinj me disavantazhe sociale duke u ofruar atyre mbështetje për tu fuqizuar dhe marrë pjese aktive në jetën e komunitetit. Qëllimi ynë kryesor është të integrojmë të rinjtë me probleme sociale dhe disavantazhe në shoqëri.

Objektivat e organizates janë:

- Mbështetja e të rinjve me disavantazhe sociale për të zgjidhur në mënyrë të pavarur problemet që ata ndeshin në jetën e tyre të përditshme.
- Krijimin e mundësive për fuqizimin e individëve me më pak mundësi se të rinjtë e tjerë për të bërë zgjedhje të lira dhe për të arritur plotësimin profesional në jetë.
- Kryerja dhe nxitja e një sërë shërbimesh të adaptuar për nevojat e çdo të riu.



- Organizimi i të rinjve në grupe të ndryshme shoqërore duke ndihmuar për përmirsimin e zhvillimit të tyre në plan personal dhe social.
- Lëvizja drejt një modeli social për aftësinë e kufizuar.
- Ndërgjegjësimi i të rinjve me aftësi të kufizuar dhe shoqërisë për të drejtat e tyre
- Eliminimi i diskriminimit kundër individëve me aftësi të kufizuar

Nga Maji 2010 e në vazhdim, Përtej Barrierave është Pikë Kontakti për Shqipërinë për programin Erasmus+ Youth in Action të Komisionit Evropian. Në kuadër të kësaj, Përtej Barrierave ofron mbështetje dhe informim për të gjitha organizatat dhe individët e interesuar për të njohur programin Erasmus +YiA. E+ u jep mundësi shumë të rinjve të aftësohen dhe të mësojnë më shumë përmes trajnimeve me metodologjinë e edukimit jo-formal si dhe u jep një shans organizatave Shqiptare të realizojnë trajnime, seminare, shkëmbime rinore apo vullnetarizëm afat-gjatë dhe afat-shkurtër.

RRETH PROJEKTIT

Europe4All është një projekt ku organizata Përtej Barrierave është partnere së bashku me pesë organizata të tjera: Cross Culture International Foundation CCIF nga Malta, Pia La Torre ONLUS, Itali, Kontakte Fur Europa e.V. Gjermani, H.R.Y.O Human Rights Youth Organization nga Italia, dhe me aplikante kryesore organizaten SFERA nga Maqedonia Veriore

Ky projekt synon t'i japë qytetarëve evropianë dhe atyre jo-evropianë mundësinë për të qenë protagoniste në krijimin e një Evropë më të përkushtuar, nëpërmjet punës reciproke të njerëzve nga kultura të ndryshme dhe kontekste të ndryshme sociale mbi tema me interes të madh për shoqërinë civile, BE dhe institucionet.

Objektivat kryesore: të promovojnë vlerat e BE-së dhe të mirën e BE-së, të respektojnë proceset zgjedhore në vendet partnere dhe në BE në përgjithësi, pjesëmarrja e votimit në vitet e fundit, propozon zgjidhje për problemet, angazhon të rinjtë nga organizatat partnere për t'u bërë qytetarë aktivë, të promovojnë vullnetarizmin dhe qytetarinë aktive, të thellojë njohurinë e të rinjve në lidhje me institucionet dhe politikat e BE-së, të kuptojnë proceset demokratike dhe t'i motivojë ata që të zhvillojnë një lidhje më të fortë me të qenit qytetar evropian

Kohëzgjatja e projektit: 01.10.2018 - 01.03.2020

OBJEKTIVAT E TOR

Përtej Barrierave po kërkon **një ekspert** për një studim mbi problemin e pjesëmarrjes së ulët në votime. Si pjesë e hulumtimit, duhen vëzhguar 300 vetë për pjesëmarrjen e ulët në votime dhe pjesëmarrjen e ulët demokratike për të parë pikëpamjet e tyre mbi këto tema. Studimi duhet të sigurojë statistika nga vendi për pesë vitet e fundit duke iu referuar një hulumtimi desk research

bazuar mbi te dhenat zyrtare ne Shqiperi. Ky hulumtim duhet të jetë i disponueshëm në formë elektronike ne gjuhen Angleza, ne daten 25 Gusht 2019.

REZULTATET E PRITSHME TË KËTIJ AKTIVITETI:

Rezultati konkret i këtij aktiviteti është një studim mbi problemin e pjesëmarrjes se ulët në votime në Shqipëri. Në studim duhet të jenë të përfshira edhe pikëpamjet demokratike të të intervistuarve. Në studim duhet të jenë të përcaktuara edhe statistika për pesë vitet e fundit, si dhe pse ka një pjesëmarrje të ulët ne votime gjatë kësaj periudhe.

PROFILI I EKSPERTIT TË KËRKUAR

- Eksperiencë në fushën e kërkuar dhe në edukimin jo-formal
- Rezident/e në Shqipëri
- Aftësi të shkëlqyera gjuhësore në të folur dhe shkrim te gjuhës angleze.
- Të jetë i/e aftë në përdorimin e mjeteve dixhitale
- Përvojë gjithëpërfshirëse në sigurimin e konsulencës
- Të jetë i/e aftë të punojë në grup dhe të mirëpresë sugjerime nga stafi I organizatës
- Të ketë njohuri dhe eksperiencë në fushën e jurisprudence, të ketë njohuri të mjaftueshme mbi situatën politike në vend.

PËRGJEGJËSITË

Eksperti/ja e kontraktuar duhet të:

1. Të ketë bashkëpunim të ngushtë me stafin e organizatës Përtej Barrierave dhe te jetë i/e hapur ndaj sugjerimeve
2. Të kryejë studimin e kerkuar në kohën e duhur dhe rigorozitetin e kërkuar
3. Të ketë diplome të shkolles se lartë ne profilin Juridik ose Shkenca Sociale
4. Të përdorë materialet e vëna ne dispozicion nga organizata Përtej Barrierave

MARRËVESHJA ME KONTRAKTUESIN:

1. Eksperti/ja i/e përzgjedhur do të nënshkruajë një kontratë me organizatën kontraktuese Përtej Barrierave.
2. Pagesa e ekspertit/es do të kryhet sipas rregullave të aplikuara me kontratë shërbimi. Pagesa e ekspertit do të kryhet siç është parashikuar në kontratën e shërbimit të firmosur nga Kontraktuesi dhe i Kontraktuari.



PERIUDHA E KONTRAKTIMIT

Periudha e kontraktimit është 1 muaj, nga data 25 Korrik 2019 deri në 25 Gusht 2019.

Procedurat e aplikimit:

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentacionin si më poshtë:

- Curriculum Vitae e rifreskuar me të dhënat e fundit
- Letër interesi
- Evidenca ose shembuj nga eksperiencat e ngjashme të mëparshme
- Eksperienca të mëperparshme pune me studime te ngjashme
- Oferta financiare

Proçesi i përzgjedhjes:

Propozimet e marra do të vlerësohen sipas kriteve të mëposhtme:

- Ana teknike e propozimit (eksperienca, CV-ja) (70%)
- Çmimi (30%)

KU TË APLIKONI

Dërgoni aplikimin tuaj me të gjithë dokumentat e kërkuara në një e-mail të vetëm në adresën: office@beyondbarriers.org deri më 18 Korrik 2019, ora 12:00 AM.